



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.04.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe Financat, datë 19.03. 2021.

2.Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i aktit normativ nr. 9, datë 22.03.2021, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Institutit të Shëndetit Publik dhe Distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanavi ve Ticaret*” A.S. “Për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër *COVID-19 (Vero Cell) CoronaVac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co, LTD*, dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës””.

3.Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i aktit normativ nr. 10, datë 24.03.2021, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanavi ve Ticaret*” A.S. “Për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër *COVID-19 (Vero Cell) CoronaVac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co LTD* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”.

4. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i aktit normativ nr. 8, datë 22.03.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar””.

5.Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i aktit normativ nr. 12, datë 25.03.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Krenar Rryci, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Rolant Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Artur Roshi, Edlira Hyseni, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Korab Lita, Eljo Hysko dhe Suzana Topi.

Të ftuar :

Adela Xhemali – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Besart Kadia – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Ergys Misha – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Saimir Muçmataj – Drejtor Juridik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna – Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Të nderuar kolegë, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Sot në rendin e ditës së komisionit kemi për shqyrtim disa çështje:

Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Ekonominë dhe Financat, datë 19.03.2021.

Shqyrtimin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i aktit normativ nr. 9, datë 22.03.2021, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Institutit të Shëndetit Publik dhe Distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanavi ve Ticaret*” A.S. “Për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër *Covid-19 (Vero Cell) CoronaVac* të krijuar nga *Sinovac Life Science Co, LTD*, dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”. Relatore është Blerina Gjylameti.

Shqyrtimin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i aktit normativ nr. 10, datë 24.03.2021, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanavi ve Ticaret*” A.S. “Për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër *Covid-19 (Vero Cell) CoronaVac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co LTD* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”. Relatore është Antoneta Dhima.

Shqyrtimin në cilësinë e komisionit përgjegjës i aktit normativ nr. 8, datë 22.03.2021, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar””. Relator jam caktuar unë.

Shqyrtimin në cilësinë e komisionit përgjegjës i aktit normativ nr. 12, datë 25.03.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”. Relator është Ervin Bushati.

Të gjitha materialet ju janë vënë në dispozicion javën e kaluar në postën tuaj elektronike dhe besoj se jeni njohur me to. Para se të fillojmë shqyrtimin, bëjmë verifikimin e prezencës së anëtarëve të komisionit në këtë mbledhje: Anastas Angjeli, këtu. Arben Elezi? Present. Antoneta Dhima? Present. Blerina Gjylameti? Present. Ervin Bushati? Present. Rolant Xhelilaj? Present. Xhevit Bushaj? Present. Reme Lalaj? Po. Senida Mesi? Po. Eljo

Hysko? Mungon. Vullnet Sinaj? Mungon. Edlira Hyseni? Po. Krenar Rryçi? Po. Artur Roshi?
Na informoi se do të marrë pjesë në mbledhje.

Artur Roshi – Po, jam prezent.

Anastas Angjeli – Korab Lita? Mungon.

Ylli Shehu? Prezent. Suzana Topi? Mungon.

Meqenëse kemi kuorumin, atëherë fillojmë shqyrtimin e çështjes së parë: miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit, datë 19.03.2021. Procesverbali ju është vënë në dispozicion në postën tuaj elektronike. Ka vërejtje apo sugjerime? Nuk ka. Kush është dakord?

Miratohet.

Për të mbrojtur projektligjet janë ftuar dhe janë prezentë përfaqësuesit e qeverisë: nga Ministria e Financave, zonja Adela Xhemali, zëvendësministre, nga Ministria e Shëndetësisë, zonja Mira Rakacolli, zëvendësministre, zonja Gelardina Prodani, sekretare e Përgjithshme dhe zonja Antoneta Njehrrëna, drejtore Juridike.

Para se të fillojmë shqyrtimin e aktit normativ nr. 9 dhe më pas aktin normativ nr. 10, më lejoni të them se këto dy akte normative lidhen me aksionin më të madh human, shëndetësor, politik dhe qeveritar në shërbim të qytetarëve shqiptarë për t'u mbrojtur nga pandemia e koronavirusit. Siç dihet, qeveria shqiptare ka bërë përpjekjet maksimale dhe renditet nga vendet me pozicionin më të lartë në realizimin e kryerjes së vaksinimit të qytetarëve kundër virusit COVID-19. Me të vërtetë kanë qenë përpjekje të jashtëzakonshme të shtetit shqiptar, të qeverisë shqiptare për mundësitë e sigurimit të vaksinimit. Siç dihet, ritmi i vaksinimit të qytetarëve, pas sigurimit të disa aktiveve me vaksina, të cilat janë sot në përdorim pothuajse në të gjitha shtetet, edhe në shtetet më të zhvilluara.

Duke vazhduar edhe gjatë javës së ardhshme me gati 8 mijë vaksinime në ditë (në mos gaboj) do të arrijmë që javës tjetër të kemi vaksinuar mbi 800 mijë veta, që është një arritje shumë e madhe dhe ndërkohë vazhdojnë përpjekjet për të siguruar edhe pjesën tjetër të vaksinave dhe kjo na ka bërë të mblidhemi këtu sot për të miratuar këto dy akte normative dhe në funksion të saj edhe aktin normativ “Mbi ndryshimet në buxhetin e shtetit” për të vënë në dispozicion paratë për të përballuar këto veprime.

Gjithashtu, doja t'ju ftoja ju si komision, por edhe përfaqësuesit e qeverisë, duke qenë se kemi dy akte normative pothuajse për të njëjtën çështje, vetëm i kemi të ndara në dy pjesë, të bëjmë një paraqitje të qeverisë për të dyja aktet, pastaj dy relatorët, në mënyrë koncize të

japin argumentet njëri pas tjetrit dhe pastaj, po të kemi ndonjë diskutim, ta bëjmë dhe të kalojmë në votim veç e veç.

E theksova këtë që në fillim për faktin se kjo është një praktikë e veçantë që po bëjmë sot, që me një akt normativ tekstin e marrëveshjes dhe më një akt normativ miratojmë marrëveshjen e nënshkruar. Në praktikën e zakonshme, miratimin e tekstit përgjithësisht e ka bërë qeveria më përpara dhe ka ardhur vetëm për miratim, për ratifikim në Kuvend teksti i miratuar i marrëveshjes nga qeveria.

Padyshim që ne jemi komision për dhënie mendimi dhe kjo është një çështje më tepër legjislative e Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit të Shëndetësisë. Jam i sigurt se ata e kanë parë me shumë vëmendje dhe çdo rekomandim që kanë do ta kenë dhënë. Sidoqoftë, Komisioni i Ekonomisë, duke e konstatuar këtë gjë u kërkon atyre si komisione përgjegjëse dhe ata duhet të shprehen përfundimisht për procedurën legjislative të të dyja çështjeve, që në fakt përbëjnë një çështje të vetme.

Kështu që unë do të ftoj përfaqësuesit e qeverisë për të dhënë shpjegime për të dyja këto dhe më pas dy relatorët, Gjylameti dhe Dhima, në mënyrë koncize, me qëllim që të procedojmë më tutje.

Fjala për zonjën Rrakacolli.

Mira Rrakacolli - Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Tashmë prej më shumë se një viti sfida më e madhe e të gjitha sistemeve shëndetësore në mbarë botën ka qenë dhe mbetet përballimi i pandemisë Covid 19, pandemi e cila ka çuar në humbjen e miliona jetë njerëzish në botë dhe në Shqipëri llogaritet që ka mbi 2 mijë veta që kanë humbur jetën nga kjo sëmundje. Me gjithë përpjekjet e jashtëzakonshme të stafeve mjekësore në mbarë botën, fatkeqësisht, akoma nuk ka një mjekim specifik.

Për këtë arsye, e vetmja masë që mbetet për ta përballuar dhe për ta radikuar është vaksinimi masiv. Asnjëherë kërkimet shkencore, por edhe industria e prodhimit të vaksinave nuk ka njohur një intensitet të tillë veprimi, siç ka qenë gjatë këtij viti dhe falë këtyre përpjekjeve intensive është arritur që në botë sot të ketë mbi 200 vaksina antikovid që janë në prova studimi dhe, fatmirësisht, disa prej tyre i kanë kaluar provat dhe janë duke u përdorur gjerësisht nëpër popullata të ndryshme, duke na dhënë ne provën e shpresës se kjo pandemi do të mbarojë. Prandaj, sfida e të gjitha qeverive në mbarë botën tashmë është pikërisht sigurimi i sasive të vaksinave dhe, natyrisht, realizimi i një procesi korrekt vaksinimi.

Sigurimi i vaksinës për qeverinë shqiptare ka qenë prioritet që në fillim të planeve tona për mënyrën e përballimi të pandemisë. Janë ndjekur me vëmendje dhe me kujdes zhvillimet kudo në botë dhe në sajë të kësaj vëmendjeje dhe të këtij kujdesi kemi arritur të jemi në dritaren e parë të shpërndarjes së vaksinave nga mekanizmi Covax dhe, në sajë të përpjekjeve personale, të vazhdueshme, këmbëngulëse të Kryeministrit shqiptar, Shqipëria ka arritur të sigurojë vaksina, edhe të tjera, nga kompania Pfiser, nga Astrazeneca, vaksina të miratuara nga FDA-ja dhe nga EMA, dhe në kushtet e emergjencës, kur Shqipëria si shumë vende të tjera të botës u ka hapur rrugën edhe vlerësimit për përdorim edhe të vaksinave të certifikuara nga trupat certifikuese të vendeve prodhuese, tashmë edhe për to.

Mund ta themi me krenari, që jemi të parët në rajon për ritëm vaksinimi, për numër vaksinash për 100 persona. Kemi arritur shifrën mbi 280 mijë, jemi në përfundim të vaksinimit të personelit mjekësor, jemi në përfundim të vaksinimit të arsimtarëve, të uniformave blu, ndërsa që dje kemi filluar edhe vaksinimin e fashës mbi 60 vjeç.

Një nga vaksinat e vlerësuara është edhe vaksina CORONAVAC, e prodhuar nga kompania kineze Sinovac. Kjo vaksinë ka autorizimin e trupës certifikuese të Kinës dhe të 22 vendeve të tjera, ku përdorimi i saj po vazhdon me shumë sukses. Një nga këto vende është edhe Turqia.

Vaksina SINOVAC është vlerësuar edhe nga Komiteti i Ekspertëve të Imunizimit, që është një komitet krejtësisht teknik, permanent, i varur nga Instituti i Shëndetit Publik e nga ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale, është i përbërë vetëm nga ekspertë të vaksinimit, nga emrat më të njohur të vendit tonë dhe jep mendime e vlerësime për të gjitha llojet e vaksinave që përdoren.

Ky komitet i ka analizuar me vëmendje dhe kujdes rezultatet e fazave të studimit të kësaj vaksine, ku më mbresëlënësi është fakti se kjo vaksinë siguron 100 % shpëtimin e jetës dhe mosshtrimin në njësitë e kujdesit intensiv, gjë që përbën treguesin më të rëndësishëm të efikasitetit të një vaksine. Për këtë arsye, ky komitet e ka klasifikuar si një nga vaksinat që mund të përdoret me sukses edhe në Shqipëri. Ky konkluzion është arritur, pas shqyrtimit, në Komitetin e Ekspertëve për Menaxhimin e Pandemisë.

Kjo vaksinë ka autorizimin e përdorimit emergjent nga agjencia turke e barnave, dhe me të janë vaksinuar në Turqi 10 milionë e 372 mijë persona, nga të cilët mbi 1 milion janë personel shëndetësor, por janë vaksinuar edhe persona mbi 65 vjeç.

Theksoj faktin që janë vaksinuar personel shëndetësor, për të vënë edhe një herë në vëmendje efikasitetin që ka kjo vaksinë, sepse personeli shëndetësor është më i rrezikuari për të marrë sëmundjen, dhe natyrisht, vaksinat që përdoren për të duhet të jenë mjaft të sigurta.

Në Turqi kjo vaksinë vjen nëpërmjet kompanisë turke KEYMEN İLAÇ SANAYİ VE TİCARET A.Ş., e cila ka të drejtën e distributorit për Turqinë. Kjo kompani shprehu interesin për të bërë marrëveshje për furnizim me doza vaksine edhe për Shqipërinë, duke siguruar këtë të drejtë edhe nga kompania kineze Sinovac. Kjo kompani ka blerë nga Kina 100 milionë doza vaksine.

Pas marrjes së informacioneve edhe nga Ministria e Shëndetësisë së Turqisë, në zbatim të këtij interesi, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur një grup ndërministror e multidisiplinor për vlerësimin e kushteve të kontratës me prodhuesit apo me distributorë të autorizuar pranë tyre në lidhje me këtë vaksinë antiCovid.

Teksti i kontratës është miratuar tashmë nga Këshilli i Ministrave, e pas kësaj është nënshkruar edhe marrëveshja me këtë kompani.

Ministria e Shëndetësisë kërkon nga komisioni miratimin e kësaj marrëveshjeje, pra të tekstit dhe nënshkrimit të saj, që bën të mundur vaksinimin në mënyrë të sigurtë të shumë qytetarëve, e përveç gjësë më të rëndësishme, shpëtimit të jetës nga ky infeksion, sjell edhe një përmirësim në global, në shëndetin mendor, natyrisht edhe në ekonomië në turizëm.

Ju faleminderit!

Anastas Angjeli – Ministria e Financave, a ka ndonjë gjë për të shtuar?

Adela Xhemali – Jo, nuk kemi asgjë për të shtuar. Faleminderit!

Anastas Angjeli – Fjala për zonjën Gjylameti.

Nuk dëgjohet.

Blerina Gjylameti – Besoj se dëgjohem tani.

Anastas Angjeli – Po, tani po.

Blerina Gjylameti – Atëherë, qëllimi i projektligjit, që jemi duke diskutuar, ka të bëjë miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe Distributorit të autorizuar “Keymen İlaç Sanayi ve Ticaret” A.Ş. për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell) Coronavac të krijuar nga Sinovac Life Science CO LTD dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës.

Arsyet që diktuan ndërhyrjen e menjëhershme kanë të bëjnë me kushtet në të cilat ndodhet vendi ynë, pra në kushtet e pandemisë Covid-19, por edhe sfidën më të madhe, ashtu

si dhe për çdo qeveri, që mbetet vaksinimi i popullatës, që do të mundësonte reduktimin e mortalitetit në popullatë në rastet e rënda të shtrimit në spital, krijimin e imunitetit të turmës, reduktimin deri në eliminim të pandemisë.

Në këtë kuadër, Shqipëria, përmes mekanizmit COVAX dhe nëpërmjet marrëveshjes me kompaninë Pfizer ka mundësuar furnizimin me vaksinën Pfizer dhe Astrazeneka, duke filluar kështu që në janar të vitit 2021 vaksinimin e personelit mjekësor në vijën e parë të sulmit dhe me radhë, më pas mësuesit, punonjësit e policisë dhe të moshuarit. Këto lloj vaksinash kanë marrë një aprovim për përdorim të popullatës nga EMA dhe FDA-ja, ose nga trupat të tjerë certifikues të vendeve që prodhojnë vaksinën. Nevoja e madhe për vaksinën, si dhe zhvillimet më dinamike të procesit të vaksinimit në mbarë botën kanë diktuar vëmendjen edhe ndaj vaksinave të tjera të prodhuara në vende si Republika Popullore e Kinës apo federata ruse. Në respektim të ligjit nr. 2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar" Komiteti i Ekspertëve për Imunizimin, në cilësinë e organit këshillimor të Ministrisë së Shëndetësisë, në kuadër të vendimmarrjeve, lidhur me vaksinimin e popullatës dhe grupeve të caktuara, ka marrë në shqyrtim vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19, Coronavax, të krijuar nga Sinovax Life Science, Pekin, Kinë. Sipas këtij komiteti, bazuar edhe në informacionet shkencore publikuar në revistën "Lancet" në nëntor të vitit lidhur me rezultatet e fazës së parë dhe të dytë, Coronavax është një vaksinë që përmban virusin e inaktivizuar SARS-COV. Kjo vaksinë ka filluar provat e fazës së tretë që në korrik 2020 në Kinë, më pas në Brazil, Indonezi, Turqi dhe Kili. Aktualisht Coronavax është aprovuar për përdorimin emergjent në Kinë nga Autoriteti Rregullator, Administrimi i Produkteve Mjekësore Kombëtare dhe është aprovuar për përdorim në Azerbajxhan, Bolivi, Brazil, Republikën Domenikane, Ekuador, Hong Kong, Indonezi, Laos, Meksikë, Paraguai, Filipine, Tajlandë, Tunizi, Turqi, Ukrainë dhe Uruguai. Kjo vaksinë është përdorur edhe në vendet e BE-së si Hungaria. Përdorimi në popullatë i kësaj vaksine të certifikuar nga trupa certifikuese e vendeve prodhuese është miratuar edhe nga Komiteti i Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri, si dhe nga Komiteti i Etikës, i cili funksionon si organ i pavarur bazuar në ligjin nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar", duke siguruar garanci publike të mbrojtjes të së drejtave përmes shprehjes së opinionit të protokolleve dhe provave klinike, përshtatshmërinë e investuesve me (*nuk dëgjohet*) dhe dokumentacionit përkatës.

Gjithashtu në ministri kanë informuar për procesin e provave klinike dhe efikasitetin e vaksinës, i cili është bazuar në të dhënat e mbledhura deri në dhjetor të vitit 2020 dhe rezultoi

të ishte 91.25% dhe 71.25% dhe 97.34% në interval besimi prej 95%, dhe se kjo vaksinë, pas vlerësimeve shkencore dhe analizave të kryera në laboratorët e analizës, ka marrë autorizim përdorimi emergjent nga Agjencia Turke e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Në Turqi me Coronavax janë vaksinuar të gjithë personat mbi 65 vjeç dhe rreth 1 milionë punonjës shëndetësor dhe numri total i të vaksinuarve me këtë vaksinë është rreth 10 milionë e 372 mijë persona.

Kompania turke Ceymen Ilaç Sanayi ka shprehur interesim për të furnizuar Shqipërinë me 1 milionë doza vaksinë Coronavac të krijuar nga SINOVAC Life Science COA dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës. Kjo kompani është distributor i autorizuar në disa vende përfshirë Turqinë dhe Azerbajxhanin, si dhe është caktuar distributor i autorizuar i kësaj vaccine për Shqipërinë. Kjo kompani ka furnizuar me 6 nga 10 vaksinat e parashikuara nga programi i përgjithshëm i imunizimit në Turqi. Turqia iu përgjigj interesit tonë për procesin e vaksinimit dhe sigurisht kjo është një mundësi i favorshme pasi ka lehtësi logjistike për të transportuar vaksinën. Përmes këtij akti normativ nr. 6 të datës 10.03.2021, Këshilli i Ministrave i ka dhënë autorizimin ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin për negocimin me prodhuesit me distributor të autorizuar me qeveritë, ose institucionet e autorizuara prej tyre në vendet, që prodhojnë, ose shpërndajnë vaksinat anti-Covid, për të siguruar vaksinat, të cilat janë të certifikuara nga trupat certifikuese në vendin e prodhimit të tyre. Marrëveshja është negociuar nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim dhe është miratuar përmes këtij akti normativ. Marrëveshja përmban parashikime në lidhje me çmimin, dozat, standardin, cilësinë e produktit, dërgimin e tij në Shqipëri, sigurimin e produktit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Për sa i përket përmbajtjes së këtij akti normativ, akti përbëhet gjithsej nga tre nene. Në nenin e parë parashikohet miratimi i marrëveshjes, në nenin e dytë parashikohet përballimi i efekteve financiare, që rrjedhin nga marrëveshja dhe fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021 dhe neni i tretë është hyrja në fuqi e ligjit.

Për sa i përket arsytimit të nevojës dhe urgjencës akti normativ është në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka vlerësuar mundësinë e prezencës së rrethanave specifike të nevojës dhe urgjencës, duke përcaktuar se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative, që kanë fuqinë e ligjit për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë nga fillimi nëse nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Për sa më sipër, kjo nismë ligjore e qeverisë ndërmerret në kushtet e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 dhe kur Organizata Botërore e Shëndetësisë ka deklaruar pandemi për shkak të infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në mbarë globin.

Kështu, nëpërmjet vendimit nr.243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, situatë kjo që sjell nevojën dhe urgjencën për ndërhyrje të menjëhershme nga ana e qeverisë.

Kjo situatë ka detyruar qeverinë të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe të menjëhershëm për të mundësuar nevojën absolute dhe të menjëhershme për të siguruar vaksinën anti-COVID-19, si dhe për vaksinimin e popullatës në një kohë sa më të shkurtër, për të kufizuar apo tejkaluar pandeminë COVID-19 dhe për të ulur mortalitetin dhe numrin e rasteve të rënda në spitale. Këto masa urgjente janë tregues që nuk kanë nevojë për t'u analizuar më tej për t'u provuar se ndodhen përballë kushteve të nevojës dhe urgjencës dhe, për rrjedhojë, të plotësimit të të gjitha kushteve të nenit 101 të Kushtetutës.

Ndërkohë, për sa u përket efekteve financiare, ky akt normativ ka efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, të cilat do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

Për sa u përket të gjitha atyre që analizova më sipër dhe duke vlerësuar se miratimi i këtij akti normativ do të mundësojë vaksinimin e popullatës në një kohë sa më të shkurtër, si dhe mundëson kufizimin dhe tejkalimin e pandemisë COVID-19, u rekomandoj anëtarëve të komisionit ta miratojnë atë.

Ndërkohë, kam edhe një pyetje, nëse është e mundur.

Anastas Angjeli – Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Duke qenë se në Kuvendin e Shqipërisë janë depozituar për miratim dy akte normative, të cilat janë të parashikuara brenda së njëjtës marrëveshje, doja të pyesja, nga ana e ministrisë përse duhen dy akte normative? Pse nuk kemi pasur vetëm një akt normativ?

Anastas Angjeli – Zonja Gjylameti, pyetja juaj është e drejtë. Mbase nuk e dëgjuat, por këtë e konsumuam në fillim të diskutimit me ministrinë dhe ua lamë komisionit përgjegjës dhe Komisionit të Ligjeve të jepnin sqarime për këtë çështje. Kështu që besoj se është ezauruar.

Blerina Gjylameti- Ndjesë, sepse nuk e kam dëgjuar!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Para se t'ua jap fjalën të tjerëve, ramë dakord të flasë edhe Antoneta, se bëhet fjalë për të njëjtën përmbajtje dhe në qoftë se keni pyetje jeni të lutur t'i bëni dhe më pas në fund të votojmë të dy aktet njëri pas tjetrit.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Fjala për zonjën Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Rakacolli, për prezantimin e këtij akti normativ, i cili shqyrtohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi!

Në fakt, kolegja Gjylameti e theksoi shumë rëndësinë dhe qëllimin e këtyre akteve normative dhe unë nuk dua të ndalem shumë gjatë, por miratimi i këtij akti normativ nga Këshilli i Ministrave ka shkurtuar kohën e ndërhyrjes së qeverisë në ndërmarrjen e masave për përbalimin e situatës në të cilën ndodhemi aktualisht me procesin e vaksinimit.

Në rast se nisma do të paraqitet si një projektligj i propozuar nga Këshilli i Ministrave në rrugë normale, koha në dispozicion e Kuvendit për ta miratuar atë, si dhe procedurat e mëtejshme të parashikuara në Kushtetutë për miratimin dhe hyrjen në fuqi të aktit do të vonoheshin së tepërmi dhe ne nuk do të krijojmë mundësinë e vaksinimit të popullatës. Nëpërmjet marrjes së masave emergjente dhe nevojës për vaksinimin e qytetarëve ne do të sigurojmë vaksinimin e popullatës sa më shpejt.

Unë e vlerësoj shumë punën dhe angazhimin e qeverisë për vaksinimin e popullatës, sepse tani ka filluar vaksinimi masiv i popullatës dhe besoj e shpresoj se do ta përfundojmë shumë shpejt vaksinimin, që njerëzit t'i rikthehen situatës normale në një kohë sa më të shkurtër dhe besoj se qeveria është në rrugën e duhur për vaksinimin e popullatës.

Kryetar, nëse më lejon, do të bëja një falënderim shumë të madh për qeverinë, personalisht për Kryeministrin Rama, i cili i bëri një dhuratë qarkut të Fierit dhe jo vetëm, dy qarqeve të Jugut të vendit, Gjirokastrës dhe Vlorës, me ndërtimin e spitalit të ri rajonal, një spital për të gjithë skeptikët, një spital shumë modern, i cili do të ofrojë shërbim për qytetarët me standarde bashkëkohore dhe së shpejti do të...

Artur Roshi – Nuk jemi në fushatë tani, nuk ka sens...

Antoneta Dhima – Më vjen shumë keq, Artur, nuk ka lidhje me fushatën; është një investim i rëndësishëm që i ka munguar qarkut të Fierit dhe është një investim i cili është meritë e Kryeministrit Rama dhe këtë duhet ta themi me kokën lart dhe me zë të lartë, sepse është një investim që i ka munguar, i cili do të ofrojë një shërbim me standarde bashkëkohore për të gjithë qytetarët, jo vetëm të qarkut të Fierit.

Ky është një investim, të cilin nuk e kanë bërë qeveritë e mëparshme. Kështu që, unë gjej rastin të falënderoj qeverinë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Infrastrukturës, të cilat kanë bërë maksimumin dhe në një kohë rekord kanë ndërtuar një spital, i cili brenda prillit dhe fillimit të majit do të jetë funksional.

Artur Roshi – I iku zëri se e kuptoi që e teproi!

Anastas Angjeli – Antoneta, faleminderit!

A keni pyetje?

Edlira Hyseni - Bëtë shumë mirë që na mblodhët, rendi i ditës është i ngarkuar, pavarësisht se është e njëjta çështje, në fakt, pra miratimi i dy akteve normative dhe në mos gaboj çështja tjetër, ndryshimi i buxhetit, lidhet direkt me këtë marrëveshje, me sa ne kuptojmë.

Së pari, përshëndes fushatën e vaksinimit, sepse prindërit tanë, por të gjithë, do të kenë një mundësi për të dalë nga kjo situatë, që të gjithë bashkë po e vuajmë. Këtu nuk është çështje politike besoj, sepse vaksinimi është zgjidhja e duhur për të gjithë.

Unë nuk e kuptova, mbase nuk e kisha dëgjimin e mirë, por dua të di: pse është ky kusht i ruajtjes sekret të marrëveshjes dhe pse ne sot po diskutojmë në parim, pra të biem dakord për një marrëveshje, për të cilën ne vetë nuk jemi në dijeni? Unë, me sa pashë materialet e mbledhjes së sotme, marrëveshja nuk është pjesë, e kuptoj natyrën e rezervuar ose sekrete të saj, por nuk më duket normale që ne të diskutojmë për një marrëveshje që nuk e kemi idenë se çfarë ka brenda. Pra, pse është domosdoshmëri ruajtja sekret edhe nga deputetë dhe anëtarët e komisionit?

Gjithashtu, me sa kuptova flitet për 10 milionë dollarë dhe me sa unë diku e ndesha bëhet fjalë për 1 milion doza, pra çmimi është 10 dollarë për vaksinë? Pra, ky buxhet prej 10 milionë dollarësh bën fjalë për këtë marrëveshje dhe për 1 milionë doza vaksinash, që do të thotë 500 mijë të vaksinuar? Pra, po flasim për një marrëveshje për vaksinimin e 500 mijë personave? A jam e saktë? Të paktën nga relacioni kam shqyrtuar këto elemente, por mirë do të kishte qenë të kishim dhe vetë marrëveshjen.

Anastas Angjeli – Edlira, të lutem, bëre një pyetje për koston për 1 vaksinë.

Edlira Hyseni - Dua të disa nëse jam e saktë që po marrim 1 milion doza, siç unë e kam kuptuar në relacion, apo jam unë e pasaktë?

Anastas Angjeli – Do ta specifikojë zëvendësministrja, por besoj e ke kuptuar se the që është edhe projekti i ndryshimit të buxhetit. Pra, përballohet vaksinimi nga buxheti i shtetit dhe nga asnjë qytetar i Shqipërisë.

Edlira Hyseni - Pyetja tjetër është: brenda cilit afat kohor parashikohet të sigurohet sasia e vaksinës, 1 milion dozat e vaksinës? A mendoni se nëpërmjet këtij furnizimi ne do të mbulojmë nevojat totale të vaksinimit të popullsisë, apo parashikohet të kemi nevojë për marrëveshje të tjera?

A është parë mundësia që negocimi të bëhet direkt me prodhuesin kinez dhe jo me ndërmjetësimin turk, duke çuar eventualisht në një kosto më të ulët, mendoj me logjikë? Pra, a është bërë një tentativë e tillë, apo ka qenë e pamundur dhe e vetmja mundësi furnizimi është patjetër nëpërmjet ndërmjetësimit të Turqisë, kur, në fakt, vakcina prodhohet në Kinë?

Meqenëse kemi këtu zëvendësministren, e tha edhe Blerina, por tha disa shifra dhe unë nuk e kam të qartë: cila është mbrojtja, që parashikohet të ofrojë kjo vaksinë, që ne i themi vakcina kineze në tërësi sa është mbulimi, sa është mbrojtja me dozën e parë dhe sa duhet të jenë të kujdesshëm dhe sa duhet të presin deri te doza e dytë? Në këtë rast na jepet një informacion i rëndësishëm, meqenëse të gjithë prindërit tanë, që po vaksinohen tashmë, duan të kuptojnë sa eficiente është kjo vaksinë dhe sa i mbron ata.

Ju faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Artur, fjala për ju.

Artur Roshi – Faleminderit, kryetar!

Do t'i mëshoj sërish pyetjes që ceku edhe Edlira. Kur qeveria kishte ndër mend që ta sillte vaksinën nga Kina, pse nuk e mori drejtpërdrejtë nga prodhuesi (Kina), por nëpërmjet një kompanie turke, e cila ka, sigurisht, një kosto të shtuar për buxhetin e shtetit në këtë rast, e cila është shuma integrale e taksave të qytetarëve? Kjo rëndon mbi qytetarët në mënyrë të tërthortë.

Pyetja ime është: sa është diferenca midis çmimit të fabrikës dhe çmimit të sjellë nga kompania? E bëj këtë pyetje për të ditur ngarkesën ekstra për qytetarët me metodën që ka zgjedhur qeveria.

Së dyti, kur qeveria vaksinon mjekët, pse vaksinon vetëm ata që punojnë në spitalet shtetërore dhe jo edhe ata që punojnë në spitalet private?

Pse vaksinon vetëm mësuesit që punojnë në shkollat publike dhe nuk vaksinohen edhe ata që punojnë në shkollat jopublike?

E njëjta pyetje është edhe për sistemin parauniversitar, për kopshtet shtetërore dhe ato private.

Pra, këtu ka një handikap. Pse qeveria përdor dy standarde dhe tregohet diskriminuese me privatin?

Është një koncept i gabuar në lidhje me kapitalizmin, apo cili është problemi këtu?

Anastas Angjeli - Faleminderit, zoti Roshi!

Për pyetjen e fundit do të përgjigjem unë, pasi ndoshta nuk e ke informacioni e plotë. Janë vaksinuar mësues dhe pedagogë edhe të institucioneve publike, edhe atyre private dhe një nga këto institucione unë e njoh shumë mirë, se është institucioni që drejtoj si president nderi, që është universiteti “Mesdhetar”, ku janë vaksinuar para dy javësh tek Arena e Futbollit të gjithë ata punonjës që figurojnë të regjistruar në organet tatimore nga ana e institucionit tonë, të cilët kanë pasur dëshirë të vaksinohen pedagogët. Kjo do të thotë se vaksinimi është shtrirë si në institucionet publike, ashtu edhe ato private. Këtë e gjë e kam konkrete, kam listën këtu.

Kanë filluar vaksinimin, të siguroj 100%, sipas një radhe të caktuar, sipas arsimitarëve, pedagogëve, edukatoreve e kështu me radhë.

Edhe për Edlirën e kisha një përgjigje, para se t’ia jap fjalën zonjës Rakacolli. Kur i dërgojmë materialet elektronikisht, duhen parë me vëmendje. Për shembull, një pyetje juaj ishte se deri kur do të realizohet kjo. Kjo gjendet në relacion, ku thuhet se do të realizohet deri në fund të vitit. Por nuk dua të merrem më këtë, pasi kishte pyetje më të rëndësishme, të cilave do t’u përgjigjet zonja Rakacolli.

Fjala për zonjën Rakacolli.

Mira Rakacolli – Faleminderit!

Duhet të keni parasysh një gjë, e thashë me një fjali, që sfida më e madhe e qeverive të të gjitha vendeve është sigurimi i vaksinave. Pra, nuk ka vakcina për të gjithë botën në të njëjtën kohë. Ndaj e theksojmë gjithmonë: është meritë e veçantë e Kryeministrit arritja e sigurimit të këtij numri vaksinash. Kjo është arsyeja që kemi dashur që në një kohë sa më të shkurtër të sigurojmë doza vaksinash. Do t’i marrim ato nga Kina apo nga Turqia, e rëndësishme është t’i gjenim sa më parë, nga vinin, natyrisht, edhe kostoja për ardhjen nga Kina do të ishte më e madhe sesa për ardhjen nga Turqia. Kështu që, në total ju siguroj që për sa i përket koston të mos keni asnjë shqetësim.

Fakti që u morën nga Turqia ka të bëjë pikërisht me atë që i gjetëm në një kohë shumë të shkurtër. Këto vakcina do të jenë të pranishme deri në fund të majit, ku do të arrijmë të bëjmë një gjë, që nuk e ka bërë rajoni, pra që të kemi jo aq sa ka thënë Kryeministri, 500

mijë, por edhe më tepër persona të vaksinuar, në mënyrë që t'i japim frymë ekonomisë, t'i japim frymë turizmit.

Në lidhje me efikasitetin, kemi thënë gjithmonë se ne duam të sigurojmë një vaksinë që të jetë shumë e sigurt. Siç e thashë, efikasiteti i vaksinës, në radhë të parë, vlerësohet me vlerën që ka për mbrojtjen e jetës. Në lidhje me përqindjet e rezultateve, meqenëse zonja Hyseni kërkon më tepër arsye teknike, gjej rastin t'ju informoj se përqindja e efikasitetit del në bazë të vendit ku është përdorur, grupit të popullsisë ku është përdorur dhe me metodikën e studimit që është bërë. Çfarë do të thotë kjo? Pra, të thuash që një vaksinë është efikase apo jo, do të thotë që këtë vaksinë ta përdorësh te një grup njerëzish dhe ky grup njerëzish të jenë përballë një infeksioni për të parë nëse do ta marrin apo nuk jo infeksionin. Nëse bëhet një studim i tillë, ku disa njerëz, pasi marrin vaksinën, vendosen së bashku me një grup njerëzish ku mundësia e ekspozimit është shumë e lartë, pra incidenca e sëmundjes është shumë e lartë, natyrisht, mundësia për ta marrë është më e madhe se në rastin kur po të njëjtët njerëz, që kanë bërë të njëjtën vaksinë, do të futeshin në një vend ku incidencea e sëmundjes do të ishte më e vogël dhe mundësia për ta marrë do të ishte më e vogël. Prandaj, diferencat që dalin në studime, kanë të bëjnë me mënyrën se si ajo është përdorur. Gjej rastin këtu për të bërë komentin për vaksinën kineze që thuhet se e ka efikasitetin më të vogël. Nuk e ka aspak më të vogël, sepse ai rezultat është nxjerrë në Brazil në kohën kur qarkullonte virusi brazilian, kur rastet e reja ditore ishin në shifra shumë të larta dhe në një kohë kur studimi për vaksinën *Pfizer* është bërë në një kohë kur numrat në atë vend që është bërë vakcina kanë qenë sa gjysma e numrave që kanë qenë në Brazil. Pra, në Brazil është marrë parasysh vaksinimi i personelit shëndetësor. Gjithashtu, është quajtur rast i infektuar edhe ai rast që ka qenë asimptomatik, por PCR-ja i ka dalë pozitive. Ndërkohë, ata që e kanë bërë vaksinat *Pfizer* dhe *AstraZeneca* kanë marrë si infeksion jo vetëm PCR-në, por edhe pasjen e një shenje apo dy shenjave klinike, pra edhe kriteret kanë qenë të ndryshme. Prandaj, unë e thashë që në fillim se Komiteti Teknik i Ekspertëve të vaksinimit, që është i përbërë vetëm me persona teknikë dhe ka përgjegjësi për të gjitha llojet e vaksinave që kanë hyrë dhe vazhdojnë të hyjnë në Shqipëri, pra jo vetëm për vaksinat anti-COVID, e ka parë me shumë vëmendje, me shumë profesionalizëm, ashtu siç e kanë parë edhe Komiteti i Etikes dhe Komiteti i Imunizimit. Ne themi me shumë përgjegjësi para të gjithë qytetarëve shqiptarë se vakcina kineze *Sinovac*, është shumë efikase dhe ka 100% garanci se ata që e kanë marrë, nuk kanë humbur jetën edhe kur e kanë marrë infeksionin dhe nuk kanë pasur nevojë të shtrohen në spital dhe kjo është shumë e rëndësishme.

Për sa i përket kohës së kur formohen antitruapat, është thënë gjithmonë dhe duhet të kemi parasysh se COVID-i është një sëmundje që mjekëve nuk mund t'u kërkohen përgjigje të prera. Është thënë dhe vazhdon të thuhet se absolutisht nuk dihet se sa zgjat imuniteti për çdolloj vaksine. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se jo çdo person i ka aftësitë imune njëloj dhe jo te çdolloj personi veprojnë në të njëjtën kohë antitruapat. Prandaj njerëzit kanë nevojë edhe për dy doza vaksine dhe doza e dytë për vaksina të ndryshme merret në kohë të ndryshme, për *Pfizer*-in merret pas 3 javësh, për vaksinën kineze merret pas 4 javësh, kurse *AstraZeneca* ka një diapazon më të gjerë dhe mund të merret edhe pas 4 deri në 16 javë. Pra, gjatë gjithë kësaj kohe njerëzit duhet të vazhdojnë të përdorin masat e mbrojtjes parandaluese, që është përdorimi i maskave, distancimi fizik social, higjiena personale e të tjera gjëra që ne nuk rreshtim së përmenduri dhe ky informacion jepet në momentin që ata vaksinohen.

Për sa i përket faktit të...*(nuk dëgjohet)* me prodhueset ose me distributorët, në bazë të ligjeve të tregtisë, ruhet konfidencialiteti i çmimeve, por ndoshta ato mund t'ju vihen në dispozicion. Fakti që janë bërë dy akte normative për të njëjtin subjekt, pra edhe aprovimi i tekstit, edhe nënshkrimi i marrëveshjes, janë bërë pikërisht se kjo ngjarje është një gjë e pazakontë për sistemin tonë legjislativ dhe për këtë arsye, duke qenë se asnjëherë nuk jemi marrë me marrëveshje të drejtpërdrejta me prodhuesit ose me distributorët e tyre nga ana e legjislacionit është këshilluar, kështu është vepruar edhe me vaksinat e tjera. Kështu është vepruar edhe me *Pfizer*-in, e cila ka kërkuar një formë të rregullt të akteve normative për anën legjislative. Më thoni nëse harrova t'i përgjigjem ndonjë pyetjeje.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Besoj se nuk ka ndonjë gjë tjetër dhe mendoj të kalojmë në votim.

Artur Roshi – Zoti kryetar, dua të bëj një koment të vogël për mënyrën se si do të votoj.

Anastas Angjeli – Patjetër, por zakonisht komenti për mënyrën e votimit bëhet në fund të votimit.

Artur Roshi – Mendova ta ezauroj tani, por nuk ka problem, si të duash.

Anastas Angjeli – Dakord, por të mos bëjmë fushatë.

Artur Roshi – Jo, jo, sepse e zuri Neta radhën e fushatës.

Antoneta Dhima – Nuk ka lidhje me fushatën, ajo që është punë, është punë, zoti Roshi. Ne duhet ta themi, ajo që është e vërtetë, është e vërtetë, nuk ka lidhje me fushatën.

Anastas Angjeli – Neta, e lëmë, jemi në rregull. Zoti Roshi nuk do të bëjë fushatë.

Artur Roshi – E para, unë nuk mund të votoj një gjë që nuk e kam lexuar, sepse nuk e kemi marrëveshjen për ta lexuar.

Anastas Angjeli – Nëse nuk e keni parë, kjo është çështja juaj.

Artur Roshi – Jo, nuk e kam parë materialin, sepse nuk më ka ardhur. Edhe Edlira e shprehu si shqetësim dhe përderisa janë dy persona ndoshta sekretaria nuk e ka dërguar, këtë nuk e di, por unë nuk e kam.

Anastas Angjeli – Në rregull.

Artur Roshi – Së dyti, unë them se është një vaksinë, që ka shumë risk. Nga se nisem? Duke parë të gjitha vendet e renditura, të cilat e aplikojnë këtë si vaksinë, këto nuk janë vende për t'u marrë si model. Për shembull: Azerbajxhani, Bolivia, Filipinet, hyjnë te vendet e dorës së tretë. Unë them që qytetarët shqiptarë boll janë renditur si qytetarë të vendeve të dorës së tretë, besoj se duhet të dalim nga kjo dhe duhet të kemi njëllor kurajoje për të dalë nga kjo dhe për këtë duhet të jenë qeveritë, për t'i radhitur qytetarët si qytetarë të dorës së parë. Këtu nuk ka asnjë vend perëndimor.

Anastas Angjeli – Është Hungaria, e cila është anëtare e Bashkimit Europian, që ka marrë 5 milionë vaksina.

Artur Roshi – Po është vetëm një, mund të ketë lajthitje edhe në Bashkimin Europian...

Anastas Angjeli – Por jo të marrë 5 milionë vaksina, të cilat janë 2 herë më shumë se Shqipëria.

Artur Roshi – Dakord.

Anastas Angjeli – Po thuaje se është në listë.

Artur Roshi – Jo, nuk është në listën e relacionit. Por kjo nuk e përgjithëson, sepse unë them për vende të zhvilluara si Gjermania. Në këtë kontekst, do të thotë që vaksina ka risk.

Moralisht, unë si individ, nuk do të votoj pro, për të mos marrë asnjë mëkat, sado të vogël, qoftë edhe për një mungesë jete, që mund të ketë nga përdorimi i saj. Qeveria ka kurajë dhe e merr përsipër, kjo është punë e saj. Qeveritë e perëndimit prandaj nuk e marrin përsipër, për shkak të riskut të madh që ka.

Së treti, vetë shefi i zyrës së ekspertizës kineze u shpreh se vaksina ka probleme. Sigurisht, nëse jemi para faktit që nga pa gjë, më mirë ta bëjmë vaksinën, dhe për këtë jam dakord, por kjo është një gjë tjetër. Ne nuk të themi që një kompani turke ka shfaqur interes

për të sjellë vaksina dhe ne do t'ua marrim. Kompanitë prandaj janë, për të çuar vaksina në të gjithë tregun ku absorbohen nga qeveritë që bien pre e tregut që ajo ofron.

Ne nuk mund të themi që na mjaftojnë informacionet që jep kompania. Për shembull, qeveria nuk ka informacione nga prodhuesi, ka thjesht certifikimet e këtyre komiteteve, të cilat janë sisteme të akreditimit. Këtu nuk kemi të bëjmë me një sistem akreditimi, akreditimin nuk e jep dot Komiteti Teknik në Shqipëri apo në të gjitha vendet që e kanë miratuar. Prandaj, në këtë kontekst, unë them se kjo nuk është vaksina e duhur.

Nëse themi që do të vaksinohen 500 mijë veta brenda majit, nëse i pjesëtojmë me 2, i bie 250 mijë veta, pra do të thotë që ekonomia nuk mund të hapet totalisht me 250 mijë veta të vaksinuar. Prandaj të mos e themi që është një arritje shumë e madhe vaksinimi i 500 mijë vetave të vaksinuar.

Po e mbyll duke thënë se do ta votoj kundër për këto dy arsye:

E para, për shkak se nuk mund të votoj një marrëveshje që nuk ekziston, pra nuk e kam lexuar.

E dyta, për shkak të riskut të madh që ka kjo vaksinë.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Roshi!

Kalojmë në e votimin e aktit normativ nr. 9, datë 22.03.2021 për miratimin e tekstit të marrëveshjeve midis institucioneve që unë përmenda, që të mos i përsëris.

Votojmë projektin në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër, zoti Artur. Abstenim? 1 abstenim, zoti Krenar.

Miratohet me shumicë votash.

Neni 1.

Kush është dakord?

Atëherë, meqenëse jemi në procedurën e aktit normativ, votohet vetëm një herë.

Ky akt u votua.

Faleminderit!

Akti nr. 10.

Votimi i marrëveshjes së nënshkruar.

Kush është dakord me aktin normativ nr. 10, datë 24.03.2021? Kundër? 1 kundër, zoti Artur. Abstenim? 1 abstenim, zoti Krenar.

Miratohet akti normativ nr 10, datë 24.03.2021, me 1 votë kundër dhe 1 abstenim.

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.04.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i aktit normativ nr. 8, datë 22.03.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Krenar Ryçi, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Rolant Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Artur Roshi, Edlira Hyseni, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Korab Lita, Eljo Hysko dhe Suzana Topi.

Të ftuar :

Adela Xhemali – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrrena – Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Anastas Angjeli - Vazhdojmë me aktin normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar”.

Kemi prezentë përfaqësuesit e qeverisë, zëvendësministren e Financave, zonjën Adela Xhemali, dhe drejtoreshën e Përgjithshme, zonjën Mimoza Dhembli.

Gjithashtu, janë prezentë përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë në mbështetje të tyre.

Për të prezantuar projektin e ndryshimit të buxhetit, do t’ia jap fjalën zëvendësministres dhe më pas unë, në cilësinë e relatorit, do të bëj relatimin përkatës për këtë çështje.

Fjala për ju, zonja zëvendësministre.

Adela Xhemali – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, ka përgatitur rishikimin e dytë të buxhetit 2021 përmes aktit normativ nr. 8, datë 22.03.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar”, nisur nga fakti që në gjysmën e dytë të muajit mars të vitit 2021 Ministria e Financave dhe Ekonomisë mori dijeni zyrtarisht për kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për fonde shtesë, në masën rreth 1 miliardë lekë, për financimin e kryerjes së pagesave për sigurimin e vaksinave të nevojshme për përballimin e situatës pandemike për të dyja aktet normative që sapo diskutuam.

Rishikimi i ligjit të buxhetit të vitit 2021 propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ për sa kohë që aspekti i nevojës dhe i urgjencës së tij lidhet pikërisht me domosdoshmërinë imediate për kryerjen e pagesave në fjalë, bazuar në skedulin e rakorduar me kompaninë.

Në këto kushte, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në analizat dhe vlerësimet e saj për ecurinë e deritanishme të treguesve të buxhetit të vitit 2021, si dhe pritshmërinë e performancës së tyre deri në fund të vitit 2021, i paraqiti Këshillit të Ministrave këtë akt normativ, i cili mundëson dhe garanton financimin e nevojshëm për shpenzimet anticovid 19. Garantimi i disponibilitetit financiar, në çdo rast, përbën dhe do të vazhdojë të përbëjë një prioritet të qenësishëm për qeverinë edhe përgjatë vitit 2021.

Duke qenë përballë një situatë dinamike, si nga pikëpamja e ecurisë së violencës së COVID-19, dhe rrjedhimisht edhe nga pikëpamja e masave të qeverisë për sigurimin e suportit të nevojshëm financiar për këtë qëllim në tërësi dhe vaksinimin në veçanti, u pa e arsyeshme që, përmes këtij akti normativ, të rritej kufiri i rezervës së buxhetit të shtetit dhe jo drejtëpërdrejt akordimi i fondeve për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim pasjen e një fleksibiliteti eventuale në përdorimin e këtyre fondeve, rast pas rasti, sipas nevojave që mund të shfaqen në vijim.

Nisur nga ky këndvështrim, sjell në vëmendje se akti normativ i përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe i miratuar nga qeveria, përcakton vetëm 1 ndryshim në shpenzimet buxhetore, një rialokim midis dy nënzërave të fondit rezervë 2021 dhe përkatësisht shtimin e 1 miliardë lekëve të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, me qëllim përballimin e shpenzimeve të blerjeve të vaksinave gjatë vitit 2021, si dhe të shpenzimeve të tjera eventuale të qeverisë, që lidhen me pandeminë COVID-19, dhe pakësimin me 1 miliardë lekë të rezervës për studime dhe projektme në kuadër të riorientimit të prioriteteve të qeverisë gjatë situatës pandemike COVID-19 për vitin 2021, projekte që parashikohen të shtyhen për 6-mujorin e dytë të vitit 2021.

Në përfundim, është me rëndësi dhe çmuj të ritheksoj se përtej rialokimit, balancimit të këtyre dy zërave, ky akt normativ nuk prek asnjë nga parametrat kyç makrofiskalë, që janë të ardhurat, shpenzimet e përgjithshme, deficitin buxhetor dhe borxhi publik, të cilat mbeten të pandryshuara nga ky akt normativ. Në këtë rast, nëse më lejoni, unë do të dëshiroja të bëja edhe një minipikturë të disa prej treguesve kryesorë, duke qenë se INSTAT-i ka dalë së fundi edhe me shifrat e reja të GDP-së. Pra, do të bëja një përmbledhje shumë të shkurtër, nëse është okej, zoti kryetar, të ecurisë më të fundit të indikatorëve kryesorë makrofiskalë.

Anastas Angjeli – Po, patjetër.

Adela Xhemali – Gjatë vitit 2020 rritja ekonomike pati një kontraktim prej 3,3% kundrejt vitit 2019, megjithëse një prej refleksioneve më të forta në dekada, sërish theksojmë që rezultati është shumë më i përmbajtur sesa pritshmëritë tona fillestare që vijonin nga minus 6,1% deri në minus 8%. Gjithashtu, edhe fundamentet e tjera më të rëndësishme kanë qëndruar përgjithësisht stabël.

Deri më tani pasojat në tregun e punës nuk duket të kenë qenë aq shqetësuese sa ishin pritshmëritë fillestare. Shkalla e papunësisë në tremujorin e fundit të vitit 2020 ishte 12,3% me një rritje marginale nga niveli prej 11,6%, që shënonte në fund të vitit 2019.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet relativisht i fortë, nën rrethanat. Tkurrja e mprehtë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve është kompensuar nga pesha e lartë strukturore e importeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat, gjithashtu, kanë pasur një rënie të ndjeshme.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një tepriçë relativisht të lartë, ndryshe nga shqetësimet fillestare, kryesisht në sajë të flukseve hyrëse në formën e huamarrjes së huaj të qeverisë.

Ne i kemi diskutuar në komision edhe eurobondin, edhe kreditë e tjera koncesionare, veçanërisht kredinë nga FMN-ja dhe asistencën makrofiskale që kemi marrë nga Komisioni Europian. Të gjitha këto ishin në funksion të mbulimit të deficitit gjatë pandemisë.

Gjatë muajve të parë të vitit rezulton se eksportet e mallrave janë rritur me rreth 1% gjatë periudhës janar-shkurt...

Artur Roshi – Kryetar, nuk besoj se ia vlen ky informacion për ne.

Anastas Angjeli – Besoj se ia vlen për qytetarët. Kështu që edhe 1 minutë kohë.

Artur Roshi – Për qytetarët le të dalë në konferencë për shtyp nga ministria! Kështu nuk ka sens.

Anastas Angjeli – Vazhdoni edhe 1 minutë.

Adela Xhemali – Okej. Deficiti fiskal në vitin 2020 arriti 7% të prodhimit të brendshëm bruto nga një mesatare prej afërsisht 2% në tre vjetët e mëparshme, megjithatë rezultoi më i ulët sesa limiti ligjor prej 8,4%, ndërsa borxhi publik arriti në nivelin 76%, pothuajse me një rritje prej 10% krahasimisht me vitin 2019, por sërish më i ulët sesa pritshmëritë tona prej 80%.

E gjykojmë me interes, meqenëse ky është Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shumë faleminderit për vëmendjen!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Më gjerë mund t'i shikoni në faqen e Ministrisë së Financave, sepse i gjithë informacioni është publikuar.

Po marr fjalën me këtë rast si relator i projektaktit normativ të paraqitur për ndryshimet në buxhet.

Besoj se është e qartë për të gjithë që të gjitha aktet normative tashmë janë të argumentuara nga pikëpamja ligjore dhe ajo kushtetuese, si dhe nga pikëpamja e nevojës për

shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19. Kështu që edhe ky akt normativ për ndryshimin e buxhetit nga këto pikëpamje që theksova më sipër vjen tërësisht i argumentuar.

Është i dyti ndryshim në radhën e ndryshimeve me akt normativ të projektit të miratuar në dhjetor, i cili është shndërruar në ligj “Për buxhetin e shtetit për vitin 2021”, por edhe si i pari, edhe ky i dyti, pa asnjë ndikim në treguesit kryesorë makroekonomikë në ata të rritjes ekonomike, të deficitit buxhetor të borxhit publik dhe të inflacionit. Pra, është një rialokim i brendshëm në buxhet, i cili bazohet në një prioritizim të situatës në të cilën ndodhemi, në kushtet e përballimit të COVID-19, të pandemisë, veçanërisht lidhur me të dyja aktet normative të kaluara më sipër nga ne që kanë të bëjnë me sigurimin e vaksinave.

Kur kemi miratuar buxhetin, i kemi vënë në dispozicion Ministrisë së Shëndetësisë mjetet e nevojshme financiare për të siguruar vaksinat. Ka edhe një pagesë, siç e dini, të bërë që atëherë për t’i siguruar. Tani jemi në pjesën që, falë përpjekjeve të qeverisë, siç e diskutuam, janë siguruar vakcina të tjera dhe duhen përballuar financiarisht. Për këtë bëhet ky ndryshim në buxhetin e shtetit me këtë akt normativ për të kaluar 1 miliard lekë nga fondi për projektet, i cili ishte i parashikuar në buxhet. Kjo çështje kalon për t’u diskutuar në gjashëmujorin e dytë dhe këto fonde kalojnë në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave për t’u vënë në dispozicion për të përballuar sigurimin e vaksinave, për vaksinimin e qytetarëve shqiptarë. Besoj se është një veprim i brendshëm. Në qoftë se më lejon Ministria e Financave, kam dy-tri sugjerime.

Sugjerimi i parë është që para se të diskutohet në Parlament dhe të zbardhet për të shkuar në Presidencë, duhet që tabela nr. 4, që ju e zëvendësoni me këtë akt normativ, të vijë në Exel edhe më e qartë, sepse kështu siç është nuk lexohet. Ne e kuptojmë që i vetmi ndryshim që bëhet është 1 miliard, por duhet të jemi të saktë nga pikëpamja edhe teknike, edhe profesionale, edhe financiare, edhe legjislative. Nuk mund të çojmë në Presidencë një tabelë me foto, ku s’merret vesh se çfarë shifrash ka aty, kështu që, ju lutem shumë, na e ridërgoni në Exel, që t’ia paraqesim Kuvendit, edhe për ta dërguar pastaj për dekretim. Duhet të jemi shumë të saktë, se kemi të bëjë me buxhetin e shtetit, kemi të bëjmë me gjëra financiare.

Së dyti, në funksion të asaj që zëvendësministrja, kur prezantoi situatën ekonomike dhe financiare në bazë të të dhënave që ka nxjerrë edhe Instituti i Statistikave, INSTAT-i, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, duhet të vazhdojmë me të njëjtin temp, për të ruajtur targetin që kemi vënë apo për t’i përmirësuar ato, për këtë vit që jemi në vazhdim.

Jemi edhe në situatë zgjedhjesh dhe duhet që administrata publike, administrata fiskale, të jetë në krye të detyrës, sidomos për 3 çështje kryesore.

Çështja e parë ka të bëjë me mbledhjen të ardhurave. Tani gati-gati ka mbaruar 3-mujori i parë dhe në këtë situatë, pavarësisht se është situatë zgjedhjesh, duhet që administrata fiskale, aq më tepër kemi edhe fillimin e procesit të fiskalizimit, të jetë në krye të detyrës, me qëllim që të sigurojë burimet e nevojshme financiare, për të vazhduar veprimtarinë normale të shtetit dhe funksionimin e të gjithë programeve që ka qeveria.

Së dyti, po me këtë këndvështrim, dua të them që, në përputhje me kuadrin ligjor ,të bëhet një analizë e menaxhimi të suksesshëm të shpenzimeve. Ne kemi miratuar një kuadër ligjor shtesë, që në atë periudhë të fushatës elektorale të mos kemi ndikim dhe kjo deri tani është ruajtur në mënyrë shumë serioze, dhe duhet të vazhdojë ky seriozitet, për të dëshmuar që ne vazhdojmë të menaxhojmë shpenzimet publike në përputhje me programin e qeverisë, pa asnjë ndikim nga situata politike.

Së treti, ajo që ka qenë dhe është gjithnjë një tërheqje vëmendjeje për të gjitha organet financiare dhe sidomos menaxhimit të financimit të investimeve, që ka qenë së fundi edhe nga Banka Botërore, të vazhdojnë të menaxhojnë me shumë kujdes, për të mos krijuar as më të voglin shqetësim dhe risk, për buxhetin e shtetit dhe për borxhin publik, investimet me partneritet publik-privat që ne kemi miratuar deri tani dhe kemi bërë shumë ndryshime në legjislacionin e saj ne këtu në komisionin dhe Kuvendi i ka miratuar, duke respektuar ato ndryshime.

Faleminderit!

Kush ka pyetje? Dhe ju ftoj ta miratojmë menjëherë, që t'i vëmë në dispozicion paratë për vaksinën. Kush ka ndonjë pyetje, mund ta drejtojë, por kemi të bëjmë vetëm me një rialokim të brendshëm të fondeve, pa cenuar absolutisht asnjë lloj treguese.

Pyetja e vetme është nga Artur Rushi, pastaj kalojmë në votim.

Artur Roshi – Kuptohet.

Zëvendësministrja, këtu na tregoi statistikën rreth...

Anastas Angjeli – Nuk do flasim për statistikën, do flasim për ligjin, the, tani...

Artur Roshi – Një koment të vogël dhe e mbarova. Dy fjali.

Anastas Angjeli – Në rregull.

Artur Roshi – Unë reagoja dhe dua të justifikoj reagimin pse nuk doja, kjo është logjika ime. Atëherë, pse nuk doja unë që të shprehej zëvendësministrja? Nuk doja që të

shprehej, sepse lind pyetja: në qoftë se ne nuk do të ishim në këtë periudhën parazgjedhore, a do të reagonte INSTAT-i?

Besoj që jo.

Anastas Angjeli - Më fal, Artur.

INSTAT-i ka një afat ligjor, kur duhet t'i nxjerrë dhe t'i bëjë publike të dhënat.

Artur Roshi – E di.

Anastas Angjeli - Atëherë, ju kërkoj vetëm këtë, lexoni të dhënat që janë në faqen zyrtare, shumë shkurt, pesë tregues. Të gjitha i ke të publikuar. E ka me ligj, me detyrim, që të jemi të qartë.

Artur Roshi – Po, po, e kam të qartë, por kur INSTAT-i thotë që ekonomia ka rënë minus 3,5%, si ka mundësi, kur në gjithë Europën dhe në të gjithë botën ekonomitë rrahin te shifra mbi 5%, kaq e konsoliduar paska qenë ekonomia jonë? Mirë që themi minus 3,5 %, por ajo rritja që ne prisnim, për shembull 2,5%, sa ka qenë në vitin 2019, vetëm me kaq shkon te 5% ose 6% ? Kështu që le t'i lëmë këto demagogjitë parazgjedhore.

Pyetja ime konkrete në raport me aktin normativ është kjo: në momentin kur zëvendësministrja relatonte aktin m'u kujtuan njerëzit që blejnë duke shënuar emrin në listë sa të vijë data e rrogës. Pra, qeveria sa kalon një muaj shton një akt normativ. Në dhjetor ne e bëmë pak a shumë një akt normativ të kësaj natyre. Pra, nuk e mendoj qeveria që mund të ishte e integruar brenda edhe kjo? Unë mendoj që kjo tregon papjekuri ose pavëmendjen totale të qeverisë. Ka lëshuar pa fre çdo gjë dhe kur i del problemi bën një akt normativ. Pra, sa është numri i alokimeve që është bërë në buxhetin e shtetit për vitin 2020 dhe vazhdojnë në 2021-in në mënyrë proporcionale? Nuk ka numër të përcaktuar, ndaj mendoj që nuk është serioze.

Uroj që ky akt normativ të jetë i fundit dhe të futemi në rrjedhën e normalitetit!

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Nuk po ia jap fjalën zëvendësministres, Artur.

Procedura me akt normativ në raste kaq të jashtëzakonshme siç jemi ne është procedura më e saktë ligjore dhe kushtetuese.

Artur Roshi – Në ishim në pandemi edhe në dhjetor.

Anastas Angjeli – Ne nuk mund të parashikonim nëse do të merrnim dot vaksina nga kinezi apo nuk do të merrnim dot vaksina nga turku. Ato që ne kishim të sigurta në momentin që në dhjetor ishin deklaruar për të gjithë botën që mund të siguroheshin ne i përfshimë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë. Atëherë kemi shtuar 1,2 miliardë lekë për këtë çështje

në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërsa, për sa i përket veprimeve dhe dinamikës së prodhimit, të shpërndarjes dhe të sigurimit të vaksinave jo vetëm Shqipëria, por dhe Gjermania deklaroi se është në bisedime me Rusinë për 20 milionë vakcina Sputnik, ndërkohë që ne edhe sot e diskutojmë është miratuar apo jo. Anglia dhe mori përsëri vaksinën AstraZeneca.

Artur Roshi – Anglia e ka prodhuar vetë, si mos ta marrë?

Anastas Angjeli – Dinamika e prodhimit, shpërndarjes dhe e miratimit të vaksinave nga institucionet përkatëse dhe e mundësisë për të negociuar me ta dhe për të siguruar atë ka qenë kaq e madhe saqë ne duhet të jemi në të njëjtën dinamikë dhe duhet ta mirëpresim këtë veprim të qeverisë që edhe ajo të negociojë. Patjetër që duhet të sigurojë edhe mbështetjen financiare, aq më tepër që këtu bëjmë fjalë për rialokim të brendshëm në buxhetin e shtetit dhe kjo nuk mund të bëhet me akt normativ. Ne nuk mund të bëjmë sot një parashikim nëse do të marrim një lloj vaksine tjetër nga një shtet tjetër që mund të jetë shumë më e suksesshme, shumë më e miratuar nga të gjitha institucionet. Nëse do të sigurojmë vakcina të tjera në nëntor përsëri do të bëjmë një akt ligjor që të sigurojmë paratë për ta marrë atë.

Nga kjo pikëpamje reagimi që qeveria ka një vit që bën dhe me sa di unë janë mbi 46 akte normative, jo thjesht për buxhetin, por për të gjithë veprimtarinë që kishte të bënte me tërmetin dhe me Covid-19, (12 janë këtij viti deri tani dhe 36 të vitit të kaluar) është reagimi më i shpejtë dhe më normal për të përballuar një situatë të jashtëzakonshme. Kur të kthehemi në normalitet do të kalojmë procedurën normale në Kuvend. Edhe kjo është një procedurë shumë normale.

Artur Roshi – Kryetar, ne sot rrisim fondin rezervë të Kryeministrit, ndërkohë që mund ta bënim që në dhjetor. Kjo është ideja ime.

Anastas Angjeli – Kjo është edhe një nga pyetjet që kisha unë, përveç atyre tri rekomandimeve që bëra.

Artur Roshi – Ato i kisha edhe unë, por ma more tabelën.

Anastas Angjeli – Ne duhet të jemi të sigurtë që do t'i gjejmë të gjitha këto dhe do të shkojmë me një propozim më të qartë për vitin. Pas zgjedhjeve do të kemi përsëri një akt normativ ku do të ndryshojmë edhe disa tregues të buxhetit për të pasur një situatë më të qartë, çfarë ka ndodhur tani dhe çfarë pritet që të ndodhë.

Nuk besoj se keni gjë tjetër, ndaj ju falenderoj të gjithëve! Ju ftoj që të kalojmë në votimin e aktit normativ nr. 8 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021””, të ndryshuar.

Kush është dakord me aktin normativ? Faleminderit! Abstenim? Nuk ka. Kundra? zoti Roshi.

Miratohet akti normativ nr. 8, datë 22.03.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar””.

Faleminderit!

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 13.04.2021, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – Kryetar komisioni

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës të aktit normativ nr. 12, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”.

Marrin pjesë:

Anastas Angjeli, Senida Mesi, Krenar Rryçi, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Rolant Xhelilaj, Ylli Shehu, Arben Elezi, Artur Roshi, Edlira Hyseni, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Vullnet Sinaj, Korab Lita, Eljo Hysko dhe Suzana Topi.

Të ftuar:

Besart Kadia - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Ergys Misha - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Saimir Muçmataj - Drejtor Juridik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Anastas Angjeli - Kalojmë te çështja e fundit.

Çështja e fundit është akti normativ nr. 12, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”. Zëvendësministri, zoti Besart, është prezent. Relator është zoti Bushati.

Zoti Zëvendësministër, fjala për ju.

Besart Kadia- Faleminderit, zoti kryetar!

Përhëndetje të gjithëve!

Ky akt normativ ka për qëllim garantimin e funksionalitetit të regjistrit të pronarëve përfitues, i cili parashikon zgjatjen e afatit që ligji vë në dispozicion për subjektet përfituese raportuese për ta regjistruar pronarin e tyre përfitues në regjistrin e pronarit përfitues, si dhe afatin në rastin e regjistrimit të ndryshimit të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese.

Sipas ligjit nr. 112/2020, detyrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues e kanë subjektet raportuese ekzistuese dhe subjektet raportuese të krijuara rishtazi, pas krijimit të RPP-së. Regjistri është bërë efikas nga data 01.02.2021, datë në të cilën është publikuar në e-Albania, dhe është mundësuar regjistrimi i të dhënave të pronarëve përfitues, por rezulton se janë shfaqur problematika teknike, të cilat prekin funksionalitetin e tij dhe, për rrjedhojë, janë të nevojshme të rregullohen, me qëllim ofrimin në mënyrë të plotë e të duhur të këtij shërbimi për subjekte, të cilat kanë detyrimin ligjor të raportimit të pronarit përfitues. Për afatin 60-ditor, që ka qenë fillimisht, pas konsultimeve me komunitetin e biznesit dhe të gjitha organizatave të tjera është rënë dakord për një shtyrje prej 90 ditësh. Në këto kushte, me ndryshimet e këtij akti normativ, është vlerësuar se parashikimi i një kohe të nevojshme për regjistrimin e problematikave teknike të shfaqura lidhur me regjistrin e pronarëve përfitues dhe funksionalitetin e tij, afati për përmbushjen e detyrimit ligjor nga subjektet raportuese të zgjatet deri në datën 30.06.2021.

Me ndryshimet e këtij akti normativ është vlerësuar që në rastin e ndryshimeve të të dhënave të pronarit përfitues të subjektit raportues ky njësim të bëhet brenda 90 ditëve nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik.

Gjithashtu, me anë të aktit normativ synohet të bëhen edhe disa saktësime të gabimeve materiale të mëparshme.

Besoj se të gjithë biem dakord që, duke qenë se edhe penaliteti për subjektet ka qenë në vlerën 200 mijë lekë dhe për të shmangur çdolloj keqkuptimi, ka qenë e domosdoshme shtyrja e këtij afati, në mënyrë që t’u jepet kohë të gjitha subjekteve, të cilat janë me pronarë

përfitues të huaj. Pra, të gjitha subjektet që ndodhen jashtë Republikës së Shqipërisë dhe kanë pasur nevojë për noterizime, përkthime dhe apostilimin e të gjitha dokumenteve, në mënyrë që të mos u jepet penalitete, është menduar shtyrja në këtë periudhë kohe.

Ju faleminderit!

Anastas Angjeli - Faleminderit, zoti Kadia!

Zoti Bushati, fjala për ju.

Ervin Bushati - Ashtu siç është shpjeguar edhe nga qeveria, situata e shkaktuar prej pandemisë bëri që edhe ky akt normativ të vijë për të përshpejtuar proceset dhe për të bërë një përafrim me legjislacionin ndërkombëtar, më saktë me Bashkimin Europian.

Janë 5 pika që ndryshohen, të cilat janë në relacionin përkatës dhe kanë të bëjnë me rregullimin e ligjit. Kështu që, ftoj të gjithë kolegët, edhe të opozitës, ta miratojnë, sepse ndihmon në funksionimin më të mirë të legjislacionit, të shtetit dhe në ekonominë reale.

Faleminderit!

Anastas Angjeli- Faleminderit!

A ka pyetje? Po, zonja Edlira.

Edlira Hyseni – Unë kam dy pyetje, sepse e kam ndeshur implementimin e këtij ligji në praktikë....

Anastas Angjeli- Afrohuni pak, ju lutem!

Ngrijeni zërin e mikrofonit në maksimumin e mundshëm që ta kuptojmë pyetjen.

Edlira Hyseni – Kam dy pyetje.

Kam pasur mundësi ta shikoj zbatimin dhe implementimin e këtij ligji. Meqenëse afatin e ka pasur deri më 30 mars bashkë me bilancin, pyetja e parë është: pse u vonuat kaq shumë për të marrë vendimin për shtyrjen e afatit për implementimin e tij, duke i stresuar bizneset vendase, kur dihen vështirësitë që pati ky ligj në zbatim?

Pyetja e dytë, ashtu siç ju e thatë, ndryshimi është skadenca, që është 30 qershori, në rastin e subjekteve që kanë administratorë ose ortakë shtetas të huaj, në kushtet e pandemisë, kur lëvizja është ende e pamundur, pra që të vijnë e të shkojnë, dhe të gjitha vështirësitë e tjera, a nuk mendoni se ka nevojë për ndonjë ndërhyrje tjetër që lidhet ekskluzivisht me të huajt? Pra, në rastet kur subjektet detyruese për zbatimin e këtij ligji mund të jenë vetë të huajt qofshin ortakë, qofshin administratorë është parë që ka qenë torturë dhe pamundësi për të arritur zbatimin e këtij ligji. Pra, përveç afatit, që unë jam shumë dakord, se bëtë shumë mirë, madje është vendim i vonuar, a nuk mendoni se ka nevojë për ndonjë përmirësim, lehtësim apo qoftë edhe për përjashtim të subjekteve që kanë vetëm shtetas të huaj në

strukturën e tyre, sepse, realisht, është krijuar kaos dhe panik te subjektet tregtare me menaxhim apo me përbërje të kapitalit të huaj? Nëse keni ndonjë mundësi për ta riparë atë pjesë, unë mendoj se është rasti për t'u bërë, sepse, realisht, ka pasur vështirësi në zbatimin e këtij ligji, ka qenë një stres i madh bashkë me kohën e bilanceve.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Hyseni!

Zoti Kadia, a mund t'u japësh një përgjigje këtyre dy pyetjeve?

Besart Kadia – Patjetër?

Faleminderit edhe për komentin!

Biem dakord se ky është një hap i duhur që është mirëpranuar edhe nga komuniteti i biznesit.

Gjithashtu, dua të theksoj se ligji është miratuar vitin e shkuar dhe të gjithë kanë qenë në dijeni, të paktën bizneset kanë qenë në dijeni se kur do të fillonte aplikimi i ligjit, pra nuk është se filloi në datën 1 shkurt, por kanë qenë të informuar qëkur është aplikuar ligji; në dhjetor kanë qenë të informuar se do të bëhej edhe regjistri i pronarëve përfitues. Pra, po ta marrim në tërësi, është pothuajse një vit kohë deri më 30 qershor që të kenë qenë të informuar dhe të kenë pasur mundësi për dokumentet. Jam dakord me ju që, për shkak të pandemisë, disa prej subjekteve të huaja kanë pasur vështirësi dhe për këtë arsye është shtyrë edhe për 90 ditë të tjera. Pra, duke ditur se kanë qenë të informuar dhe duke qenë se e dinin që afati ka qenë 30 marsi, pra po ta marrësh në tërësi, kanë qenë 6 muaj për të përgatitur dokumentet, pra besoj është e mjaftueshme kudo në botë që të krijohet kjo mundësi. Ne besojmë se me këtë informim, me këtë shtyrje dhe me këtë rigorozitet nuk do të ketë shtyrje tjetër, sepse subjektet janë informuar, kanë marrë masa dhe ne kemi pasur kontakte me të gjitha dhomat e huaja të tregtisë, të cilat kanë qenë dakord. Pra, është dakordësuar me ata për të afat kohor me pretendimin tyre se është e mjaftueshme për të mos pasur problematika në të ardhmen.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Kadia!

Zoti Roshi, a keni pyetje?

Artur Roshi – Nuk pyetje.

Doja që ai 3-tremujorshi të bëhej 4 muaj, nëse do të jetë dakord përfaqësuesi i ministrisë.

Anastas Angjeli – Është akt normativ, një akt normativ ose votohet, ose nuk votohet. Kështu që ju ftoj që ta votojmë aktin normativ që ka të bëjë me këtë çështje që diskutuam deri tani.

Kush është dakord? Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet me të gjitha votat akti normativ.

Para se t'ju falënderoj që ishit kaq të angazhuar në këtë mbledhje, duhet të bëj një njoftim për javën e ardhshme. Ndoshta ditën e martë do të bëjmë një mbledhje tjetër të komisionit, ku do të shqyrtojmë dy raporte: raportin e Autoritetit të Konkurrencës dhe raportin e Bankës së Shqipërisë. Materialet do t'ju vihen në dispozicion në postën elektronike. Do t'ju lutesha shumë që lajmërimi të bëhet një javë më përpara që të keni mundësi ta vendosni në axhendë. Mbledhja do të bëhet ditën e martë, në orën 10:00, pra që të keni mundësi të merrni pjesë gjysmë ore në këtë mbledhje, sepse janë dy raportimet e Autoritetit të Konkurrencës dhe të Bankës së Shqipërisë. Më pas ose brenda javës ose pas javës së ardhshme do të bëjmë edhe një mbledhje tjetër që ka të bëjë me raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, që sapo ka ardhur dhe me ndonjë akt ligjor që mund të na vërë në dispozicion qeveria. Por të martën e ardhshme në orën 10:00 kemi këto dy çështje, ju lutem për pjesëmarrjen tuaj.

Faleminderit dhe punë të mbarë të gjithëve!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti

